

**BASHKIA POLIÇAN**  
NJOFTIM ANKANDI

1. Autoriteti dhënies në përdorim: Bashkia Poliçan, (adresa, nr. tel) Lagjia “Qender” Poliçan  
Tel: 036824200 , e-mail: njvbashkiapolican@gmail.com
2. Data e zhvillimit të ankandit 27.11.2023, ora 10:00.
3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit : Procedurë e Hapur
4. Objekti : Dhënie në përdorim të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor “Për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë”.
5. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes: Dhënie në përdorim të pasurisë nr 1890/3 zk 3572 e llojit kullote sip. 488252 m<sup>2</sup>, pasuria nr 1889/3 zk 3572 e llojit kullote sip. 1410000 m<sup>2</sup>, pasuria nr 1889/1 zk 3572 e llojit kullote sip. 511748 m<sup>2</sup>, pasuria nr 958/3 zk 3584 e llojit kullote sip. 791990 m<sup>2</sup>, pasuria nr 974/4 zk 3584 e llojit kullote sip. 208010 m<sup>2</sup>, në pronësi të bashkisë Poliçan për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë .
6. Vlera fillestare: 60117600 (gjashtedhjetë milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind ) Lekë/Vit .  
(Referuar V.K.M-së Nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si edhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” shtojca 1 /pika 8).
7. Afati i dhënies në përdorim: është 10(dhjetë) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.
8. Vlerësimi i ofertave konkurruese do të bëhet me pikë si vijon:
  - projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekti përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit - 20 pikë;
  - planbiznesi dhe investimet që do të bëhen -15 pikë;
  - planin e rehabilitimit të sipërfaqes -25 pikë;
  - nivelin e punësimit në veprimtari -5 pikë;
  - masën e qirasë për ha/vit -35 pikë
9. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë kërkuar, në dokumentet standarde të konkurimit.
- b) ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- d) në rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e të cilit depozitohet pranë komisionit të vlerësimit të ofertave.
- e) vërtetim nga prokuroria, gjykata që subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore se nuk ka detyrime tatimore, si dhe vërtetim për shlyerjen e Taksave Vendore.
- f) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan-biznes.
- g) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV në profesionale të tregohet prova në fushën e veprimtarisë.

10. Dokumentacioni i nevojshëm:

- a. Kërkesën e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore, së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- b. Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- c. Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- d. Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- e. Planin e rehabilitimit të sipërfaqes;
- f. Nivelin e punësimit në veprimtari;
- g. Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- h. Adresën e subjektit, telefon, e-mail dhe faks;
- i. leje mjedisore për aktivitetin e kërkuar
- j. ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë.

11. Vendi i zhvillimit të ankandit/Adresa: Bashkia e Poliçan

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: 27.11.2023, ora 10:00..

13. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të terhiqen pranë autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

|         |         |     |       |                          |
|---------|---------|-----|-------|--------------------------|
|         | Po      | X   | Jo    | <input type="checkbox"/> |
| Nëse Po | Monedha | lek | Çmimi | 1000                     |

14. Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbal/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

15. Dokumentacioni duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për dhënie përdorim”, dhe i dorëzohen komisionit të posaçëm për vlerësimin e dokumentacionit, në orën e hapjes së procedurës së konkurrimit. Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme ose paraqitja e dokumentave të rremë, përbën kusht skualifikues. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrimit.